



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 49 datë 27.9.2022

**“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË
MIRATUAR ME VKB NR. 3 DATË 05.01.2022 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
TË VITIT 2022 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2022-2024 TË BASHKISË SHKODËR” I NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.9.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar ; ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; udhëzimit nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”; Kontratës së grantit me nr. reference: IPA 2022/432-378 ndërmjet Autoritetit Kontraktor i përfaqësuar nga Komisioni Evropian dhe organizatës “Të Ndryshëm Të Barabartë” si partner lider i projektit, Bashkisë Shkodër dhe organizatës “Ketro Merimnas Oikogeneias Kai Paidiu” si bashkë-aplikantë në projekt; Marrëveshjes së partneritetit me nr. 9913 Prot, datë 17.06.2022 ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe organizatës “Të ndryshëm Të barabartë”; VKB nr. 19, datë 10.05.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”; VKB nr.3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 3 datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të bashkisë shkodër” i ndryshuar për projektin “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)” të detajuar si më poshtë: shtesë e planit me burim financimi donacion, me vlerë 7,865,673.7 Lekë. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian nën thirrjen EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri” dhe udhëhiqet nga organizata “Të Ndryshëm Të Barabartë”.

Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë, nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim i Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues). Projekti do të zbatohet me llogari jashtë thesari, me llogari speciale në bankën e nivelit të dytë dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:				
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzim e kapitale të trupëzuar ara	Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma 2022	2,293,866	245,094.5	32,381.5	229,890		1,786,500
Shuma 2023	2,321,902	1,435,039	189,602	697,261		
Shuma 2024	2,479,924	1,689,862.4	223,261.6	566,800		
Shuma 2025	769,981.7	99,973	13,208	656,800.7		
Shuma totale e Projektit e financuar nga programi	7,865,673.7	3,469,968.9	458,453.1	2,150,751.7		1,786,500

2. Miratimin e nivelit të pagës për punonjësën e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2022. Në vitin 2022 projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin e menaxherit të projektit sipas tabelës më poshtë. Menaxheri i projektit është planifikuar të punojë 4 muaj në vitin 2022.

Viti 2022 Punonjës me kontratë që paguhet nga donatori (Për periudhën 4 muaj)

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	1		IV-a	36,000		
Numri i Punonjësve	1					

3. Miratimin e mbulimit të shpenzimeve të TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve të cilat nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërit nga “Investime kapitale të trupëzuara” (Llog 231) nga programi 09240 “Arsim i mesëm profesional” fishë projekti P09240.O1.A10 Rikonstruksioni I objektit të ish shkollës “Veterinare”, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, tek zëri “Investime kapitale të trupëzuara” (Llog 231), fishë projekti i planifikuar P10430.O2.A5 TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Tabela 1 Pakësime - Të trashëguara

Lekë

Nr	Nr. i Programit	Programi	Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime kapitale te trupëzuara
1	09240 (5)	Arsim I mesëm profesional	P09240.O1.A10. A1/1 Rikonstruksioni I objektit të ish shkollës “Veterinare” (Zbatim)	584,000
			TOTALI	584,000

Tabela 2 Shtesë

Lekë

Nr	Nr. i Programit	Programi	Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime kapitale te trupëzuara	Artikulli 602 Shpenzime Operative	TOTALI
1	10430 (5)	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	P10430.O2.A5 TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër. A2.1 Mobilim dhe pajisje i Klubit Social Nj.A. Dajç (20% TVSH dhe 5% garanci e punimeve, fondet e bashkisë)	298,000		298,000

2	10430 (5)	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	P10430.O2.A5 TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @ Shkodër. A3.1 Shpenzime për infrastrukturën e Klubit Social Nj.A. Dajç (Zbatim. Mbikqyrje. Kolaudim) (20% TVSH dhe 5% garanci e punimeve, fondet e bashkisë)	149,000		149,000
3	10430 (5)	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	P10430.O2.A5 TVESA@SH- Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @ Shkodër. A.8, A.9, A.9, A.7 Mbulim i vlerës TVSH për shpenzimet operative (fondet e bashkisë)		137,000	137,000
			TOTALI			584,000

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR



Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 2

Zbardhur me datë 30.9.2022